



PROCESVERBAL NGA Mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Mbledhja: Nr. 18

Datë: 22. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 16 dhe 17/2024**
- 2. Aktivitetet e SKQZ**
- 3. Aktivitetet e Zyrës**
 - Rekomandimi për regjistrim të partisë politike “PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT SHQIPTAR”
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit**

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

6. Raport i Këshillave të KQZ

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

-Shqyrtimi dhe miratimi i Kodit të sjelljes për anëtarë të KKZ-së për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kroaci dhe Maqedoni të Veriut

8. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për pjesëmarrje në trajnimin e zyrtarëve zgjedhor, të organizuar nga Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve të Koresë së Jugut

9. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në çmimet e rrjetit global për drejtësinë zgjedhore

10. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Rendin e propozuar të takimit, e paraqiti kryetari Radoniqi, i cili tha se ndër të tjera, janë edhe “tri pika” të mbyllura. Në fund, kryetari Radniqi pyeti anëtarët se a kanë diçka për të shtuar, propozuar...? Alban Krasniqi, kujtoi se pika e 6-të “Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)” të tërhiqet, nuk është për miratim. Me këtë tërheqje të kësaj pike, u miratua rendi i ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 16 dhe 17/2024:

Në vazhdim, po ashtu u miratuan edhe dy procesverbalet e mbledhjeve të KQZ –së nr. 16 dhe 17/2024.

3. Aktivitetet e SKQZ:

Burim Ahmetaj, drejtor i SKQZ-së e informoi KQZ-në lidhur me zyret e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut. Ai tha se, tashmë zyrat janë funksionale dhe se, zyrtarët e caktuar në këto komuna janë vendosur dhe veprojnë nga zyrat. Për funksionalizimin e zyrave të KKZ-ve në aspektin logjistik, përkrahje kanë dhënë komunat duke siguruar zyrat për KKZ në hapësirat e objekteve të administratës komunale në secilën komunë. Pjesa logjistike, është duke e mbuluar siq janë një pjesë e inventarit, pajisje të teknologjisë informative, internet dhe aspekte tjera administrative për zyre.

Ahmetaj, bëri të ditur se Sekretariati ka marrë veprime për pajisjen e KKZ-ve me Listën Preliminare të Votuesve dhe Listën e Qendrave të Votimit. Pastaj, funksionalizimi i QV-e dhe aspektet e tjera organizative në terren. Periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës preliminare të votuesve, për procesin e votimit që mbahet me datën 21.04.2024, ka filluar me datën 18.03.2024 dhe përfundon me datën 05.04.2024.

Sipas rregullores 03/2024 - Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, Lista Preliminare e Votuesve bëhet publike në zyrat e KKZ, në formatin elektronik, andaj këto materiale janë përjellur te ZEKKKZ përkatëse. Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2023, për iniciativën e qytetarëve për largimin e Kryetarit të Komunës nga funksioni, neni 6, KQZ duhet të organizojë votim për largimin e kryetarit të komunës nga funksioni. Procesi i votimit do të mbahet me datën 21 prill 2024.

Ahmeti e informoi KQZ-në se kërkesa për përgatitjen e ekstraktit të dytë të RQC nga Departamenti i Gjendjes Civile, përfshin sigurimin e të dhënave të të gjithë shtetasve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë të moshës 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe personat që deri me datën 21 prill 2024, mbushin moshën 18 vjeç. Ekstrakti duhet të jetë i gatshëm për pranim nga KQZ, me datën 25.03.2024 (ditë e hënë), rreth orës 12:00.

Aktivitetet tjera, janë raportet e dy komisioneve që janë bërë më herët për dy zyra. Raporti, sjell të dhëna se syra në Mitrovicën e veriut është e dëmtuar, e demoluar ashtu si edhe një pjesë e materialeve. Mirëpo, një pjesë e pajisjeve mund të përdoren.

Zyra në komunën e Zubin Potokut, nuk ka pasur pajisje dhe gjendja e zyrës është e zbrazët. Aty, nuk ka pajisje. Në komunën e Zveqanit dhe të Leposaviqit, një pjesë e pajisjeve janë funksionale. Sidomos ajo në Leposaviq, zyra është e padëmtuar, është funksionale. Ne, tha Ahmetaj, jemi në plotësimin e zyrave me materiale të nevojshme që duhen për realizimin e procesit.

Në komunitat përkatëse, na është mundur nga kryetarët e tyre se KQZ mund të vepronë në zyrat përkatëse, dhe ne jemi duke vepruar.

Sami Kurteshi, pyeti për dy çështje: se, a ka materiale arkivore, dokumente, procesverbale...?

Burim Ahmetaj, tha se në Zubin Potok zyra është shkatërruar e tëra. Kurse në komunitat e tjera, gjendja është pak më e mirë, ndërsa në Zveqan, duhet ta verifikojmë përmes një raporti tjetër.

Sami Kurteshi: Zyrarët që janë larguar, a kanë bërë raport ? Nuk mundet kjo, sepse është vepër penale, duhet të jenë dorëzuar zyrat me procedurë. Secili zyrtar publik në Republikën e Kosovës me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës duhet të bëjë dorëzim-pranimin e mjeteve me të cilat është ngarkuar për ushtrimin e funksionit. Këtë duhet ta bëjnë edhe këta ish-zyrtarë komunalë të KKZ. Moskryerja e dorëzim-pranimit është veprim i kundërligjshëm.

Burim Ahmetaj: Nuk ka pasur proces, raport...

Arianit Elshani, tha se dëgjuam një raport të qartë mbi vlerësimet, mbi përgatitjen e zyrave të reja. Megjithatë, rekomandoj që pajisjet e zyrave të deritashme, të merren, të sillen në depo. Aty ku ka mundësi, të kryhet raport – dorëzimi, të ketë një plan, tha z. Elshani.

Alban Krasniqi, tha se raporti duhet të plotësohet, sidomos në Mitrovicën e Veriut ku ka pasur veprim kriminal. Zyrarët ynë atje, kur i është kërkuar çelësi i zyrës, ka refuzue me ju përgjigjë KQZ-së!

Kam qenë aso kohe në MPAL-së, dhe e kam përjetuar atë gjendje, mirëpo pajisjet, prona e institucioneve dhe këto nuk janë çështje për diskutim. Nuk mund të sillet si vagabond, ka dhënë dorëheqje! I ka rrezikua edhe kolegët, duhet me bashkëpunue ngushtë me policinë sepse rasti është i ngritur, dhe duhet denoncue.

Është territor i Republikës së Kosovës, dhe askush nuk mund të sillet si vagabond por, duhet të përgjigjet secili sipas ligjeve. Rastet si ky, duhet të paraqiten te organet kompetente.

Në ditën kur ky zyrtar ka refuzua me i dorëzua çelësat, e ka rrezikue jetën e tjerëve. Veprimet e tij, nuk përjashtohen, sepse nuk përjashtohet që ka mund të jetë edhe pjesë e strukturave terroriste. Të këtyllët, askund në institucionet. Jeni të obliguar të ndërmerrni masa, tha Krasniqi.

Gordana Llaban, tha se nuk dëshiron të involvohet në këtë fjalim...! Në fjalën e saj, ndërhyri z. Krasniqi, i cili tha se ky është realitet, nuk është fjalim, prokuroria e ka rastin në dorë, dhe unë nuk lejoj që askush politikën e Listës Serbe dhe të Vuçiqit të na e sjellë këtu, dhe e ftoi znj. Llaban që të sillet si zyrtare e KQZ, e shtetit...

Zonja Llaban pyeti pastaj se kur zyrtarët kanë dhënë dorëheqje, a janë kërkuar të dorëzohen mjetet dhe inventari, dokumentet e zyrave nga Sekretariati ?

Burim Ahmetaj, tha se kemi kërkuar por nuk ka pas përgjigje, reagim por vetëm ata kanë thënë se çelësat janë lënë në komunë.

Zonja Llaban, pyeti edhe rreth Listës së Votuesve, dhe tha se në bazë të analizës së saj, KQZ ka pas një listë në takimin 13, 441 votues. Mirëpo, në takimin e 18 marsit, numri ka shkuar në 321 më shumë, po flas për komunën e Leposaviqit. Dhe numri është rritur për kohë të shkurtë, edhe në komunat e tjera...

Anëtarja Llabani, pasqyroi shifrat e rritura, trendët e rritura dhe ajo tha se, nuk e ka të qartë se si ka ndodhur kjo, dhe tha se mendon që diçka nuk është në rregull...?

Burim Ahmetaj, shpjegoi se në bazë të kërkesës së bërë se cili do të jetë kufiri që përcaktohet prej 20% në secilën komunë, ne kemi marrë Ekstraktin vetëm të departamentit për prodhimin e dokumenteve. Mirëpo, tha Ahmetaj, kur kemi marrë ekstraktet tjerë, i kemi marrë nga departamenti i Gjendjes Civile, kjo e banë ndryshimin sepse, databazat nuk janë të njëjta. Do ta kemi edhe një ekstrakt, dhe do të kemi listën finale të votuesve...

Sami Hamiti, tha se krahasimet që po bëhen rreth listës, tash jemi duke punuar me rregullore dhe ligje të reja, dhe përcaktohet saktë lista votuese...!

Nuk përkufizohet sa banorë janë atje, por sa janë të regjistruar. Ata, mund të rrinë diku tjetër. Por duhet ditur se, lista merret nga regjistri civil në ARC, dhe jo nga departamenti i prodhimit të dokumenteve. Mund të ketë edhe njerëz që, nuk janë çregjistruar...

Zyrtarët atje, kur kanë dhënë dorëheqje, janë sjellë më së keqi që munden. Ata, është dashur me ditë se zyrtarët janë të KQZ, jo të komunës...? Po, duhet marrë masa ndaj tyre...

Alban Krasniqi, tha se krijimi i listës votuese, merr për bazë regjistrin civil. Në listë votuese, hyjnë të gjithë qytetarët që kanë lindur në Kosovës, mirëpo ata që duan ushtrimin e votës, duhet të kenë dokument të Kosovës...

Sami Kurteshi, pyeti se a janë informue grupet e nismave qytetare për kërkesën e tyre zyrtarisht, ashtu siç është e paraparë me ligj, për votim, se është plotësuar kuota 20%? Këtë pyetje po e shtroj sepse ne kemi pranuar një postim elektronik nga znj. Sanja Krtiniq.

Burim Ahmetaj, tha se, më 8 mars është shqyrtua në KQZ, është marrë vendimi kur do të votohet. Zyrtarisht, nuk i kemi njoftuar mirëpo, vendimet e KQZ janë publike, dhe me këtë njoftohen edhe qytetarët...

4. **Aktivitetet e Zyrës**

Rekomandimi për regjistrim të partisë politike “PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT SHQIPTAR”:

Besnik Buzhala, tha se më 26 shkurt 2024 iniciativa politike “Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptarë” (PBKDSH) që udhëhqiet nga Nikoll Perkaç ka aplikuar për regjistrim. Sipas rregullores dhe ligjit, dhe veprimave të tjera përfshirë edhe pagesën, zyra rekomandin për regjistrim.

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për miratuan këtë rekomandim.

5. **Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit:**

Kreshnik Radoniqi, tha se kjo rregullore është shqyrtue, draftue. Kryetari, pasi që nuk pati vërejtje, e hodhi në votim, dhe rregullorja në fjalë, u miratua me 11 vota.

6. **Raport i Këshillave të KQZ:**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar këtë pikë. Bëhet fjalë për plotësimin e emërimeve që janë gjatë fillimit të javës. Dhe, në Leposaviq, janë bërë 2 nominime, në Zubin Potok 1, në Zveçan 1, dhe Mitrovicë e Veriut 1.

Rekomandojmë për miratim.

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për 2 abstenime, e miratuan këtë rekomandim.

Shqyrtimi dhe miratimi i Kodit të sjelljes për anëtarë të KKZ-së për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut:

Arianit Elshani, tha se një kod i këtillë propozohet për herë të parë. Tani, është edhe në bazë të rregullave por edhe është obligim ligjor, dhe se KOZ rekomandon për miratim.

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi. Që të dy, kërkuan që edhe përmbajtësish rregullorja të shihet edhe njëherë...

Në parim, anëtarët e KQZ-së e miratuan Kodin e sjelljes për anëtarë të KKZ-së për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, mirëpo me vërejtjet nga Sami Kurteshi që do të dërgohen me email.

Pjesa e dytë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kroaci dhe Maqedoni të Veriut:

Burim Ahmetaj, tha se kemi bërë analiza mbi datat, kohën, vendet të cilat potencialisht, KQZ ka nevojë me i vëzhguar zgjedhjet. Kemi bërë kontaktet, dhe rekomandimi është që një grup ti vëzhgoj

zgjedhjet presidenciale që janë në Maqedoninë e Veriut më 24 prill dhe raundi i dytë më 8 maj – bashk me zgjedhjet parlamentare, dhe një grup në Kroaci për zgjedhjet parlamentare më 17 prill.

Arianit Elshani: E kemi trajtua në KOZ një kalendar zgjedhjesh. Pra, kemi analizua të gjitha zgjedhjet e këtij viti, pra janë në Be, Belgjikë, Austri, Bosnje dhe Hercegovinë, Rumani, Irlandë dhe SHBA.

Kreshnik Radoniqi: A ka propozime për vendet Maqedoni e Kroaci ?

Pas shqyrtimit, u propozua që Sami Hamiti, Ilir Gashi dhe Ibrahim Selmanaj dhe 1 Sekretariat (4 persona: Kroaci.)

Miratohet.

Për në Maqedoni, u propozua që të udhëtojnë: Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Myfera Shinik, Fazli Stollaj, Qemajl Kurtishi. (5 nga Sekretariati)

Miratohet.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për pjesëmarrje në trajnimin e zyrtarëve zgjedhor, të organizuar nga Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve të Koresë së Jugut:

Kreshnik Radoniqi: Ky takim, është “on –line”. Konkursi, është në gjuhën angleze. Nëse kalohet testi, është pastaj trajnimi 9 ditorë...

Tre, deri në katër persona. I lamë katër...

Pas shqyrtimit, u vendos që të marrin pjesë katër persona, por gjuha angleze është e domosdoshme.

Miratohet.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në çmimet e rrjetit global për drejtësinë zgjedhore:

Burim Ahmetaj, tha se është një garë për nominim. Temat janë: *1. Integritetit dhe pavarësia gjyqësore zgjedhore. 2. Barazia gjinore. 3. Progresi specifik. (drejtësia zgjedhore)*

Pjesëmarrja duhet të bëhet deri më 31 mars.

Miratohet.

4. Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi, tha se miellin që e kemi pranua nga nisma e grupit të petitionit. Ata, po kërkojnë të bëhen pjesë e KKZ-ve, por ligjërisht nuk mund të jenë pjesë. Një përgjigje, duhet t'ua japim...!

Gordana Llaban: A mund të jenë vëzhgues, përmes ndonjë organizate ...?

Sami Hamiti: Munden përmes organizatave që janë të përcaktuar sipas rregulloreve dhe ligjeve tona. Munden me u inkorporue në organizatat tjera.

Alban Krasniqi: Munden me bashkëpunue me ndonjë organizatë, madje munden edhe me regjistruue një OJQ, ka kohë...

Kreshnik Radoniqi, tha se unë mendoj se kishim mundur me i lejue për shkak të procesit si të këtillë, sui generis. Unë po mendoj se, ata e kanë atë të drejtë...

Ne, po ua dërgojmë një arsyetim, një letër...